



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:146529

Datë: 04.07.2022

Numri i dokumentit: 03197783

C. nr. 101/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm – përmes gjyqtarit Arben Xheladini dhe zyrtarit ligjor Ardian Avdiu, në çështjen kontestimore të paditëses, Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, Rr.”Lidhja e Pejës”, magjistratja Prishtinë-Fushë Kosovë, pa nr., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson, Kompania “Credica L.L.C”, me seli në Prishtinë, Rr.”UÇK”-kati I nr.1/2, kompleksi Qafa, kundër të paditurit M.B. nga fsh..., Komuna e Vitisë, me bazë të kontestit kompensim i dëmit material dhe jo material, jashtë seance, me datë 04.07.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Konstatohet se është tërhequr padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, kundër të paditurit M.B. nga fsh..., Komuna e Vitisë, lidhur me objektin e kontestit, kompensim i dëmit material dhe jo material.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Me datë 08.03.2018, paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit, përmes përfaqësuesit me autorizim, ka paraqitur padi kundër të paditurit, M.B., lidhur me objektin e kontestit, kompensim i dëmit material dhe jo material.

Me datë 04.07.2022, gjykata e ka pranuar një parashtrësë së bashku me një kopje të autorizimit nga përfaqësuesi i paditëses, me anë të së cilës e tërheqë padinë e paraqitur në këtë gjykatë, pasi që i padituri sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 17.03.2022, e ka përmbushur detyrimin.

Sipas nenit 261.1 të LPK, paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”, andaj, pas vlerësimit të parashtrësës dhe duke pasur parasysh se i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, duke u bazuar duke edhe në nenin 387.1, pika c të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

G j y q t a r i,

Arben Xheladini

KËSHILLË JURIDIKE: Në bazë të nenit 261.4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.